



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

PËRDORIMI I GJUHËS STANDARDE SHQIPE NË ARSIMIN E LARTË (VËREJTJE)

Valbona Kalemi*

**Departamenti i Art Dizajnit, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,*

Albanian University, Tiranë

Abstrakt

Dihet që norma drejtshkrimore është pasqyra më e mirë dhe më e prekshme e zotërimit dhe e përdorimit të shqipes standard si sistemi me shtrirjen më të madhe funksionale. Shkolla shqiptare është vatra themelore e formimit gjuhësor të brezave të rinj, që i edukon me dashuri për gjuhën amtare dhe zbulon thesarin e pashtershëm të saj, ta vlerësojë përvetësimin e normave të njësuara të gjuhës letrare e të drejtshkrimit.

Metoda e përdorur. Hulumtimi është drejtuar nga rregullat e përcaktuara në “Drejtshkrimin e gjuhës shqipe” botim i vitit 1973, si dhe në një literaturë të gjerë lidhur me problematikat e sotme të drejtshkrimit. Nisur nga niveli i zotërimit të standardit në shkollë dhe kryesisht studentëve kemi hetuar nivelin e ngulitjes së normës së gjuhës shqipe duke e matur me performancën në detyrat me shkrim të llojeve të ndryshme provime, ese, detyra kursi. Të dhënat janë vjelë nga 437 gjithsej studentë të Universitetit të Elbasanit, dhe Tiranës në programe (gazetari, gazetari –anglisht, në lëndën e drejtshkrimit të shqipes e emërtuar word processing, Histori dhe Edukatë qytetare, si dhe lënda, Gjuhë shqipe dhe shkrim akademik në studentët e vitit të parë tek departamenti i Arkitekturës dega “Dizajn” në Albanian University. Viti 2018-2024, vjelja

Rezultatet. Kemi evidentuar shkelje të normës drejtshkrimore si: (drejtshkrimi i zanoreve, e, ë-së në fjalë, shkrimi i bashkëtingëlloreve dhe i grupbashkëtingëlloreve, përdorimi i apostrofit, shkrimi i fjalëve njësh, ndaras, përdorimi i shkronjave të mëdha, i nyjave cilat do i paraqesim gjatë punimit

Konkluzionet dhe rekomandimet. Nga të dhënat që kemi mund të themi se kemi mangësi në përdorimin e normës standard, si në të folur dhe në ligjërimin e shkruar të llojeve të ndryshme. Rritja e kërkesave ndaj përdorimit të normës në institucionet e arsimit të lartë dhe futja në të gjitha degët në Universitetet tona do të jetë mjaft i frytshëm.

Fjalë çelës: *çështje gramatikore, gjuhë standarde, institucionet e arsimit të lartë, roli i mësimdhënësit, shkeljet e normës*

USE OF STANDARD ALBANIAN LANGUAGE IN HIGHER EDUCATION (REMARKS)

Abstract

It is known that the spelling norm is the best and most tangible reflection of the mastery and use of standard Albanian as the system with the greatest functional scope. The Albanian school is the basic center of linguistic formation of the young generations, which educates them with love for the mother tongue and discovers its inexhaustible treasure, appreciates the acquisition of the uniform norms of the literary language and spelling.

The method used. The research is guided by the rules defined in the Spelling of the Albanian language” edition of 1973, as well as in a wide literature related to today’s spelling problems.

Based on the level of mastery of the standard in the school and mainly among the students, we investigated the level of embedding of the Albanian language norm by measuring it with the performance in written tasks of various types of exams, essays, course assignments. The data were collected from a total of 437 students of the University of Elbasan and Tirana in programs (journalism, journalism-English, in the subject of Albanian spelling called word processing. History and Civic Education, as well as the subject, Albanian language and academic writing in first –year students at the Department of Architecture, branch “Design” at Albanian University. Year 2018-2024, vintage

Results. We have identified violations of the orthographic norm such as (spelling of the vowels, e, ë in the word, writing consonants and groups of consonants, use of apostrophe, writing single words, separate words, use of capital letters, nodes which will presentation during the work.

Conclusions and recommendations. From the data we have, we can say that we have deficiencies

In the use of the standard norm, both in speech and in written discourse of various kinds.

Increasing the requirements for the use of the norm in higher education institutions and introducing it to all branches in our Universities will be of great interest.

Key words: *grammatical issues, standard language, higher education institutions, teacher’s role, norm violations*

Hyrje

Ndryshimet pas viteve 1990 në vendin tonë patën edhe pasojë në dëm të zbatimit të standardit të gjuhës shqipe. Kjo u shoqërua me një pakujdesi si në shqipen e folur dhe në atë të shkruar. Në mbarë opinionin shoqëror ka një shqetësim për mangësitë e shumta gjuhësore që vihen re në shkrime të ndryshme, në shtyp, në radiotelevizion, në botime të ndryshme e në përdorimin publik të gjuhës letrare, kjo do të thotë se norma nuk është përvetësuar mirë në shkollat tona.

Ndodhemi para një situatë ku kemi shqetësim gjuhëtarësh,¹ mësimdhënës të katedrave të gjuhës shqipe në Kosovë² e në Shqipëri³ e deri në nivel akademikësh⁴ për mangësitë e shumta gjuhësore, në lidhje kryesisht me drejtshkrimin që zbatohet në të gjitha fushat shoqërore. Ky problem është i mbarë

1 Murati, Q. A na duhet gjuha shqipe sot? Java e Shkencës, 2013, f.171, & Gashi, S., *Vlerësim apo përçundim i shqipes standarde nga nxënësit në Prishtinë* –shkaqet dhe pasojat. Java e shkencës 2013, f. 23

2 Morina, B, *Roli i mësimdhënësve në përvetësimin e normës së shkruar në shkollë*, Java e Shkencës, 2013, f.473

3 Toska, T, *Peisazhe të fjalës*, 2018

4 Shkurtaç, Gj. *Urgjenca gjuhësore*, Botues “Naimi”, Tiranë 2017 & *Kundërime gjuhësore*,

shqiptarisë. Çfarë do të thotë mosrespektimi i standardit? “... kjo flet doemos për një perspektivë të zymtë gjuhësore të asaj shoqërie” Vinca (2010; p.12-13)

Për çfarë duhet njohja e normës?

Dihet që të folurit dhe të shkruarit në gjuhën letrare kombëtare është sot një shenjë e tregues kulture. Gjuha letare është synim i përhershëm i njeriut tonë, sidomos i të rinjëve të shkolluar e të profilizuar thellë e ethshëm në shkencën e artin e dijet bashkohore, prandaj edhe përbën një dukuri reale e që s’është as thjesht punë gjuhësie, as thjesht objekt kundrimi vetëm për gjuhëtarët. Ajo është një anë themelore e jetës shqiptare që medoemos duhet pasqyruar sa më gjerë...⁵

Njohja e normave dhe e rregullave dhe çështjeve gramatikore na mësojnë të flasim dhe shkruajmë një gjuhë pa gabime. Kjo është e domosdoshme porse njerëzit kanë nevojë t’i shprehin mendimet e ndjenjat e tyre sa më bukur, sa më qartë e në mënyrë të përpiktë në përshtatje me rrethanat e mjediset e caktuar për të përmbushur funksione të caktuara.⁶

Po çfarë ndodh në përdorimin e normës në institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë?

Ndeshemi përditë me studentë të cilët nuk e zotërojnë mirë normën drejtshkrimore, por edhe shqiptimore. Norma drejtshkrimore është pasqyra më e drejtpërdrejtë me të cilën përballemi ne si mësimdhënës në ligjërimet me shkrim të llojeve të ndryshme.

Nisur nga kjo gjendje e prekshme tek studentët tanë kryesisht në Elbasan dhe Tiranë mundëm të realizonim këtë punim.

Për realizimin e saj jemi konsultuar me literaturën shkencore përkatëse⁷ punime të ndryshme shkencore⁸ profesionale dhe në ciklin parauniversitar, me sugjerime që kanë të bëjnë me shqipen standarde, planeve programeve etj., me sugjerime e problemet e standardit⁹ që janë shtruar sot para gjuhësisë në raport me standardin e vendosur në Kongresin e Drejtshkrimit 1972 dhe mendime e projekte të Këshillit Ndërkademi i Drejtshkrimit¹⁰ lidhur me standardin dhe zhvillimet gjuhësore të sotme. Gjithashtu jemi mbështetur në programet mësimore¹¹ që zhvillohen në universitetet tona. Për të argumentuar dhe pritshmërinë nga studentët tanë.

Problematikat që i shoqërojnë studentët tregojnë edhe për një kujdes që ka gjithsecili. Gjuhëtarët shprehen se kujdesi personal për gjuhën standard arrihet së pari në zotërimin e drejtë të normave të gjuhës standard,

si në fushën e drejtshkrimit, të drejtshqiptimit, të gramatikës, të leksikut, të semantikës dhe niveleve

5 Shkurtaj, Gj.(2006) Kundrime gjuhësore, Pegi, Tiranë f. 21

6 Shkurtaj Gj. Kultura e gjuhës” Shblu, Tiranë 2006, f.27

7 Kostallari, A.M. Domi, E. Lafe, Drejtshkrimi i Gjuhës shqipe, ASHSH, Tiranë 1973. R. Memushaj, Shqipja standarde. *Si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Toena, Tiranë 2011. Gj. Shkurtaj, Shqipja e sotme, Ufo Press, Tiranë 2010

8 N. Kalemi, N Bushaj, M. Dëshmi të metodave të reja në procesin e të shkruarit të nxënësve, në “Kërkime gjuhësore V”, 2016, f. 365

9 Rrokaj, Sh. Probleme të drejtshkrimit të shqipes standarde, Java e Shkencës, 2013, f.403

10 Rami, M, *Projekti ndërkombëtar i drejtshkrimit*, në “Gjuha shqipe në shtratin e prokrus-tit” INFOBOTUES, Tiranë, 2013

11 Në universitete tona zhvillohet një lëndë e posacme për drejtshkrimin e gjuhës shqipe si Word processing, dhe drejtshkrimi i shqipes standarde në Bachelor në Gazetari, Bachelor Gjuhë- Letërsi etj. si dhe vlen për të përmendur e vlerësuar edhe Universiteti privat “Albania University” që e ka futur lëndën e gjuhës shqipe në Shkencat e Aplikuara.

të tjera gjuhësore...¹²

Arti i të shkruarit do punë e durim për t'u zotëruar. Kemi arritur të shkruajmë drejt kur kemi mësuar shprehitë e të shkruarit dhe kemi marrë njohuritë e nevojshme për normën gjuhësore.

E ku mund ta shohim më mirë se tek shkollarët e në rastin tonë studentët që dhe pritshmëria është më e madhe.

2. Studimi

2.1 Pjesëmarrësit në studim

Në këtë studim kanë marrë pjesë **437** studentë gjithsej, **177** studentë të viteve të para Bachelor të Universitetit të Elbasanit dhe 260 studentë të “Albanian University” në Tiranë

-Fakulteti i Shkencave të Edukimit-Departamenti i Edukimit Qytetar (2016-2017) dhe Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies, dega: Histori ((2016-2017)

-Fakulteti i Shkencave Humane –Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë, dega: Gazetari dhe Gazetarisë Anglisht (2017-2020)

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në “Albanian University” dega: Dizajn 2018-2024

Studentët në hulumtim vijnë nga disa qytete të Shqipërisë si: Tiranë, Korçë, Libarzhid, Elbasan, Peqin, Lushnjë Kavajë, Dibër, Durrës, një numër i vogël edhe nga Kosova etj.

2.2 Materialet

Gjithësej janë 192 ese, provime 437, 300 detyra detyra kursi,

Tezat për 177 studentë kanë të qenë të njëjta, ndërsa për 260 studentë kanë qenë ndryshe vetëm në disa rubrika. Kemi redaktim pjesësh të shkëputura nga letërsia shqiptare. Të gjitha pyetjet e formuluar të mbështetura tek programi lëndor i shqipes standarde.

2.3 Procedura

Materialet e përshkruara më sipër u trajtuan duke u mbashtetur në Drejtshkrimin e miratuar nga Kongresi i Drejtshkrimit 1972, nga Shqipja standarde e Rami Memushajt, Shqipja e sotme e Gjovalin Shkurtajt.

Kemi trajtuar mangësitë e hasura në lidhje me normën duke i paraqitur ato në mënyrë të detajuar.

3. Analiza dhe Rezultati

Drejtshkrimi është tërësia e rregullave për shkrimin drejt dhe njësh të fjalëve dhe të trajtave të tyre për shkrimin e fjalëve njësh ndaras dhe me vizë në mes, si dhe për përdorimin e shkronjës së madhe... norma drejtshkrimore ashtu si normat e tjera, përcaktohet nga struktura gramatikore e gjuhës.¹³

Nga analiza që kemi bërë kemi vënë re mospërdorimin ashtu si duhet të normës së shkruar. Rregullat e Drejtshkrimit të Shqipes Standarde 1972 –it, janë të mirëpërcaktuara dhe gjithashtu mendonim se ishin të kapërcyera, por realiteti është ndryshe në të vërtetë. Pra shohim që gjuha shqipe siç pohon edhe M. Gashi “Gjuha shqipe nuk lëngon nga mungesa e rregullave drejtshkrimore, por nga moszba-

¹² Kuci, S., Studime të gjuhës shqipe, Prishtinë, 2014

¹³ Memushaj, R. Shqipja standarde, *Si të flasim dhe të shkruajmë*, Toena, Tiranë 2011, f. 135

timi i këtyre rregullave, nga gjymtimi i përditshëm që po i bëhet kësaj gjuhe...¹⁴

Në detyrat e ndryshme si ese, provime, pjesë të redaktuara vëmë re se kemi një mori problemesh të cilat na shqetësojnë përditë neve si mësismdhënës, duke ditur që këta studentë nesër janë e ardhmja e këtij vendi.

Në 437 studentët vihen re këto shkelje të normës.

3.1. Shkelje të normës drejtshkrimor e që vihen re në punimet e studentëve (në provime) por dhe në (ese.) e detyra kursi.

1-Drejtshkrimi i zanoreve, -Zanoret e theksuara, përdorimi i zanoreve (zanorja e), zanorja ë, zanorja ë paratheksore, zanorja ë fundore.

2. Grupe dhe takime zanoresh

3. Shkrimi i bashkëtingëlloreve

4. Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes

5. Përdorimi i shkronjave të mëdha

6. Përdorimi i apostrofit

7. Nyja e përparme dhe parafjalët

-Drejtshkrimi i zanoreve, -Zanoret e theksuara, përdorimi i zanoreve (zanorja e), zanorja ë, zanorja ë paratheksore, zanorja ë fundore.

-Zanorja e përdoret ë kryesisht tek studentë të cilët janë kryesisht nga të folmet jugore si nga Gjirokastra, Berati, Vlora në disa raste tek fajlet: *dhëmb, gjëmb, dëndur mënd, përqëndroj ndënja, e vrënjtur, gështënjë etj.*

Zanorja ë paratheksore

Kjo zanore sipas drejtshkrimit duhet të shkruhet në të gjitha rastet kur kjo zanore është e rrënjës së fjalës, Ndërsa ne shohim që kjo zanore në teste ku ka 10 fjalë gjithësej përdoret vetëm në dy p.sh. Përdoret gabim si: *bagti* për *bagëti*, *brryl* për *bërryl*, *drrasë* për *dërrasë*, *krrabë* për *kërrabë*, *prallë* për *përrallë*, *shplaj* për *shpëlaj*. Ky mospërdorim i ë-së mungon në pjesën më të madhe të shkrimeve.

Ndërsa ka fjalë tek të cilat përdoret saktë si: *dëborë, këndeje, këta, kështu.*

¹⁴ Gashi, S, *Vlerësim apo përçundim i shqipes standarde nga nxënësit në Prishtinë –shkaqet dhe pasojat*, Java e Shkencës, 2013, f. 23

-Zanorja ë e cila është e domosdoshme studentët nuk e përdorin në fjalët e prejardhura prej temash më –ë fundore dhe prapashtesash që nisin me një bashkëtingëllore në fjalët:

antar për anëtar, botror për botëror, puntor për punëtor, drejtsi për drejtësi, pjestoj për pjesëtoj

Përdorimi i gabuar në fjalët e përbëra dhe të përngjitura kur temë e të cilave mbaron me ë- si: *armbërës për armëbërës, i gjithfuqishëm për i gjithëfuqishëm, mirkuptim për mirëkuptim, megjithse për megjithëse.*

-Përdorimi gabuar i ë-së në fjalët e prejardhura prej temash më bashkëtingëllore dhe prapashtesash që nisin po me bashkëtingëllore në fjalët e dhëna: *kombtar për kombëtar, lajmtar për lajmëtar, harktar për harkëtar, plehroj për plehëroj, malsor për malësor.*

- Përdorimi i gabuar i ë-së paratheksore në fjalë që nuk duhet të shkruhet. Nuk shkruhet ë-ja në përemart e pacaktuar, ndajfoljet dhe lidhëzat¹⁵si:

gjithëçka për gjithçka, gjithësecili për gjithsecili, kurrëgjë për kurrëgjë, kurrëkund për kurrëkund.

-Përdorimi i gabuar i ë-së pastheksore. Rasti kur ë-ja pastheksore duhet të shkruhet. Vëmë re që ë-ja mungon në këto fjalë: *ardhsi për ardhësi, qindshe për qindëshe, të errta për të errëta.*

-Përdorimi gabuar edhe në rastet kur ë-ja nuk duhet të mungojë në fjalët: *i ftoht, i ftoft për i ftohtë, i mpreht për i mprehtë, i nxeht për i nxehtë, i zbeht për i zbehtë.*

-Gabime në përdorimin e ë-së fundore nuk e shkruajnë kur ë-ja duhet të shkruhet si:

ark për arkë, flet për fletë, furr për furrë, gjum për gjumë, ngjyr për ngjyrë, shkum për shkumë

Grupe e takime zanoresh

Shkruhen gabim fjalët me grupet *ie* dhe *-je*

-Kur kemi emra tek të cilët ky grup zanoresh ndiqen nga bashkëtingëlloraj –l, –ll, –r. si: *djell për diell, mjell për miell, kamarrjer për kamarier, kuzhinjer për kuzhinier.*

Shkruajnë gabim grupin *-je* kur duhet grupi *-ie* si: *miel për mjel, dieg për djeg,*

Gabime tek përdorimi i grupit *ie* për *je* në rastet kur kemi trajtat e njëjsit të së kryerës së thjeshtë dhe në të tashmen e dëshirores **ndiej**-ndjeva, ndjefsha, ndjefhtë.

-Përdorimi i apostrofit

Në përdorimin e apostrofit ndeshim kryesisht gabime në rastet e mëposhtme:

15 Memushaj, Rami, Shqipja standarde, Tiranë, 2004, f.142

Tek trajat e shkurtara të përbëra *ma* dhe *ta* që nuk duhen me apostrof, si dhe në rastin e përdorimit si përemër të çdo e çfarë ç' do ditë për *çdo ditë*, dhe *ç'farë bën/* për çfarë bën?

-Shkrimi gabim i bashtingëlloreve –s/ -z- dhe sh-/zh-/ ç-nistore.

Ndeshim gabime në fjalët si: *çfilit* për *sflilit*, *zpraps-* për *spraps*, *cmirë* për *smiurë*, *çfurk* për *sfurk*, ndërsa tek *sh/ zh/ ç-nistore* kemi raste të përdorimit *gabim*

çfaq për *shfaq*, *çthur* për *shthur*, *çvesh* për *zhvesh*, *shlodhje* për *çlodhje*, *shrrënjos* për *çrrënjos*.

Gabime në përdorimin e grupeve *ce/ci*. (në fjalë të huaja) në fjalë prej greqishtes dhe latinishtes. *gips* për *gjips*, *xhirafë* për *gjirafë*, *incizoj* për *incizoj*, *çentral* për *central*, *procëdurë* për *procedurë*, *çelebrim* për *celebrim*, *çertifkatë* për *certifikatë*.

-Shkrimi i fjalëve njësh ndaras dhe me vizë në mes

Gabime në shkrimin e fjalëve njësh: *indogjerman* për *indogjerman*, *nacional çlirimtar* për *nacionalçlirimtar*, *tre mujor* për *tremujor*, *proces verbal* për *procesverbal*.

Gabime në drejtshkrimin e fjalëve ndaras; *njëmijë* për *një mijë*, *njëqindmijë* për *njëqind mijë*

-Përdorimi i shkronjave të mëdha

Në rastet kur epitetet, nofkat dhe ofiqet që janë bërë pjesë e emrave të përveçëm të njerëzve, si dhe në pseudonimet. *Gjergj balsha i parë* për *Gjergj Balsha i Parë*,

Ndërsa në rastet kur shkruhet me të vogël emërtimet e ofiqeve që nuk janë bërë pjesë e emrit të përveçëm shkruhen me të vogël si: *Ali bej Këlcyra*, *Ali pashë Guçia* ¹⁶

Ndeshim gabime në këto raste: *Ali pashë Tepelena* për *Ali Pashë Tepelena*,

Shkruajnë me gabime pjesët përbërëse të emërtimeve zyrtare.

Në rastet kur ato duhen të shkruhen me shkronjë të vogël vëmë re shkrimin e tyre me të madhe:¹⁷ *Këshilli i Rrethit për këshilli i rrethit*, *Zyra e Gjendjes Civile* për *zyra e gjendjes civile*

-Gabime në përdorimin e emërtimeve më të larta shtetërore, të titujve më të lartëvhtë nderit dhe të emërtimeve e urdhërave më të lartë në Republikën e Shqipërisë. Si: *mësues i popullit* për *Mësues i Popullit*, *mjeshtër i madh* për *Mjeshtër i Madh*

-Gabime në përdorimin e nyjës së përparme dhe paraafjalët. Përdorimi i nyjës së në vend të nyjës të dhe anasjelltas si *Ministrisë të Kulturës* për *Ministrisë së Kulturës*, *Shfaqjes të Teatrit të Operës* dhe *të Baletit për Shfaqjes së Teatrit të Operës* dhe *të Baletit*, në librin e gjuhës së klasës së gjashtë, për në

16 Memushaj, R, Shqipja standarde, *Si të flasim dhe të shkruajmë*, Toena, Tiranë 2004, f. 167

17 *Shënim: Shkruhen me shkronjë të vogël; emërtimet e institucioneve shtetërore vendore*

librin e gjuhës të klasës së gjashtë ¹⁸

Përfundime

Si përfundim mund të themi se: Shqipja vijon të jetë në trysinë e shkruarve të pakujdesshëm. Shteti dhe institucionet publike që varen ose lejohen prej tij, duhet të kenë më shumë përgjegjësi....kjo duhet të marrë fund, përndryshe gjuha do të pësojë dëmtime të pandreqshme.¹⁹

1. Mosngulitja e dijes gjuhësore shqipe në mënyrë sistemore si dhe mungesa e vëmendjes së duhur për mbartësit e gjuhës po na sjell para një fakti të ri në përdorimin jo të duhur të normës së shkruar që përballemi çdo ditë në auditoret tona.
2. Njohja e rregullave dhe e normave, rregullave gramatikore na mësojnë të flasim dhe shkruajmë një gjuhë pa gabime. Kjo është tepër e domosdoshme për këdo, por më shumë për brezin e ri i cili është e ardhmja e kombit.
3. Shkolla luan një rol shumë të madh në dhënien e saktë të dijes dhe kryesisht të standardit të shqipes kryesisht atë drejtshkrimor. Po çfarë është vënë re nga hulumtimi?

Më së shumti nga hulumtimi në vëmë re se gabime të shumta bëjnë studentët në përdorimin e ë-së fundore, mbështetëse, e ë-së së patheksuar, tek *drejtshkrimi i zanoreve, -zanoret e theksuara, përdorimi i zanoreve (zanorja e) zanorja ë, zanorja ë paratheksore, zanorja ë fundore, grupe dhe takime zanoresh, shkrimi i bashkëtingëlloreve, shkrimimi fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, përdorimi i shkronjave të mëdha, përdorimi i apostrofit, nyja e përparme dhe parafjalët.*

Nga krahasimi i mangësive që kanë studentët e arsimit publik me atë jopublik (privat) shohim ndryshime, të cilat vihen re tek një përdorim më i mirë i normës nga studentët në arsimin jopublik (Albanian University). Kjo tregon se kemi studentë më cilësorë, megjithatë kjo vlen për t'u parë në vazhdim.

4. Kujdesi për zbatimin e normës nuk duhet të jetë vetëm nga mësimdhënësit e gjuhës shqipe por nga të gjithë mësimdhënësit si në parauniversitar dhe në arsimin universitar të kujtdo lënde qofshin. Më shumë kërkesë në detyrat e kursit dhe shkrimet e tjera funksionale.
5. Situata jo e mirë që po kalojmë mendoj se në të ardhmen do të ketë përmirësim me futjen e gjuhës shqipe në shkollat e mesme.
6. Futja e lëndës së gjuhës shqipe në Universitetet tona në të gjitha programet do të jetë një mundësi e mirë për rritjen e kulturës gjuhësore tek studentët e të gjitha degëve.
7. Mund të themi se të shkruarit nuk mbaron me diplomimin, por është pjesë e pandarë në të gjitha veprimtaritë e mëpastajme të individit. Kështu që vlen t'i kushtojmë rëndësinë e duhur gjatë gjithë jetës.

¹⁸ Memushaj, R. Shqipja standarde, *Si të flasim dhe të shkruajmë, Toena, Tiranë 2004* f. 175-176

¹⁹ Shkurtaç Gj. Urgjenca gjuhësore, Tiranë, 2017, f.67.

Referenca

1. Gashi, S, (2013) *Vlerësim apo përçundim i shqipes standarde nga nxënësit në Prishtinë –shkaqet dhe pasojat*, Java e Shkencës
2. Kuci, S., (2014) Studime të gjuhës shqipe, Prishtinë
3. Kostallari A., M. Domi, E.Lafe, Drejtshkrimi i Gjuhës shqipe, ASHSH, Tiranë 1973. R. Memushaj, Shqipja standarde. Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Toena, Tiranë 2011. Gj.Shkurtaj, Shqipja e sotme, Ufo Press, Tiranë, 2010
4. Rrokaj, Sh., (2013), Probleme të drejtshkrimit të shqipes standarde, Java e Shkencës
5. Shkurtaj, Gj. (2006), Kultura e gjuhës, Toena,
6. Shkurtaj, Gj. (2006) Kundrime gjuhësore, Pegi, Tiranë
7. Shkurtaj, Gj. (2017) Urgjenca gjuhësore” botues “Naimi” Tiranë & (2008), *Si të shkruajmë shqip*, Toena, Tiranë
8. Toska, Teuta. (2018) *Peisazhe të fjalës*
9. Kalemi, N & Bushaj, M., *Dëshmi të metodave të reja në procesin e të shkruarit të nxënësve*, në “Kërkime gjuhësore V”
10. Memushaj R, (2004) & (2011) Shqipja standarde, *Si të flasim dhe të shkruajmë*, Tiranë
11. Memushaj, R. (2013), *Projekti ndërkombëtar i drejtshkrimit*, në “Gjuha shqipe në shtratin e prokrustit” Infobotues, Tiranë
12. Morina, B. (2013) *Roli i mësimdhënësve në përvetësimin e normës së shkruar në shkolla*, Studime të gjuhës shqipe, Prishtinë.
13. Murati. Q. (2013) *A na duhet gjuha shqipe sot?* Java e Shkencës
14. Vinca, A (2010) *Gjuha Standarde shqipe dhe bota akademike*, Gjuha shqipe